



KOMUNIKATË

8.2.2010

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sot u mbajt mbledhje komemorative me rastin e vdekjes së anëtarit të KQZ-së, z. Xhelil Pajaziti. Komemoracioni u mbajt në shenjë nderimi të veprës jetësore, të kontributit të tij në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për për vite me radhë, dhe në shenjë të aktivitetit dhe punës në proceset zgjedhore dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Të pranishëm në këtë mbledhje komemorative ishin anëtarë të familjes Pajaziti, përfaqësues të Kuvendit dhe të Presidencës, ministra, deputet etj.

Në shenjë nderimi në komemoracion foli Kryetarja e KQZ-së, znj. Nesrin Lushta, e cila e çmoi lart jetën dhe veprën e Xhelil Pajazitit. Përvoja personale, përkushtimi dhe kontributi i Xhelil Pajazitit që ka dhënë për procesin zgjedhorë vite me radhë, është humbje e pazëvendësueshme për këtë institucion. KQZ-ja ende ka pasur nevojë për bacen Xhelë.

Kryetarja Nesrin Lushta, tha se nuk mjaftojnë fjalët për ta shprehur dhimbjen për humbjen e anëtarit të KQZ-së. Vdekja e bacës Xhelë, na ka tronditur të gjithëve. Këto fjalë që po i drejtoj, janë me plotë pikëllim dhe me tronditje shpirtërore. Fjalët nuk mjaftojnë për ti shprehur ndjenjat për humbjen e bacës Xhelë. Andaj më lejoni që në emrin tim personal dhe në emrin e anëtarëve dhe të sekretariatit të KQZ-së, t'i shpreh ngushëllimet më të thella familjes së baces Xhelë. Në këtë mbledhje komemorative, ka shprehur ngushëllimet edhe Hugh Fulton nga Departamenti për Zgjedhje i OSBE-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me këtë rast, e shpalli Xhelil Pajazitin, anëtar nderi-Post Mortum të KQZ-së.